



kji

Instituti Gjyqësor i Kosovës  
Kosovski Institut za Pravosudje  
Kosovo Judicial Institute

2015

# BULETINI

Përmbajtja:

Aktivitetet nga Programi I Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)

Aktivitetet nga Programi I Trajnimit Fillestar (PTF)

Aktivitetet Tjera

Adresa: Lagja e Spitalit

Rr. "Muharrem Fejza" p.n.

Prishtinë, Republika e Kosovës

[infokji@rks-gov.net](mailto:infokji@rks-gov.net)

<http://igjk.rks-gov.net>

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

### Trajnim “Prokurimi publik dhe mundësitë për luftim të korrupsionit”

Më 05 maj 2015, IGJK në kuadër të PTV ka organizuar trajnimin me temë: ”Prokurimi publik dhe mundësitë për luftim të korrupsionit”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i shkathësisive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me njohuritë e nevojshme për ligjet dhe kompetencat nga fusha e prokurimit si dhe fushëveprimin e institucioneve për prokurim në

zbulimin dhe hetimin e suksesshëm të korrupsionit në fushën e prokurimit.

Çështjet që u debatuan gjatë trajnimit ishin legjislacioni i Prokurimit Publik në Kosovë, Institucionet e Prokurimit Publik, roli dhe funksioni i këtyre institucioneve, procedurat e prokurimit, dosja e tenderit, hapja publike dhe vlerësimi i ofertave, korrupsioni në fushën e prokurimit, bashkëpunimi i institucioneve në luftimin e korrupsionit me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në luftën kundër korrupsionit, si dhe çështje tjera me interes për pjesëmarrësit.

Trajnimi u zhvillua me pyetje dhe përgjigje, në formë të bashkëbisedimit dhe në pjesën e pasdites pjesëmarrësit trajtuan raste nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të gjykatave themelore.



## Shqyrtimi gjyqësor

Më 07 prill 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës realizoj trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë: “Shqyrtimi gjyqësor”.

Ky trajnim qellim parësor kishte avancimin e njohurive teorike dhe praktike për çështjet që ndërlidhen me zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor dhe respektimin e procedurave për vendosje të drejtë, efikase dhe efektive të rasteve.

Prezantimet dhe diskutimet në këtë trajnim kryesisht u fokusuan në trajtimin e parakushteve për fillimin e shqyrtimit gjyqësor, urdhrin për caktim të shqyrtimit gjyqësor, fillimi i shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimi i të akuzuarit lidhur me fajësinë, afatet për mbajtjen e shqyrtimit

gjyqësor, marrja e aktgjykimit dhe rastet e shtyrjes së shqyrtimit gjyqësor.

Gjithashtu u elaboruan edhe teknikat e marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku u trajtua baza ligjore dhe qëllimi i fjalës hyrëse, marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, marrjes së tërthorët në pyetje, vënies në dyshim, ri ekzaminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthorët si dhe fjalës përfundimtare.

Trajnimi u zhvillua me diskutime për sfidat dhe problemet në praktikën aktuale me rastin e shqyrtimit gjyqësor.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë pranë gjykatave dhe prokurorive themelore.



## Aksidentet në Komunikacion

Më 12 maj 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të PTV-së realizoi trajnim për gjyqtarë me temë: “Aksidentet në Komunikacion”.



Synim i këtij trajnimi ishte kontributi në drejtim të thellimit të njohurive teorike dhe praktike tek gjyqtarët që ndërlidhen me paqartësitë tek veprat e kundërvajtjes nga lëmia e komunikacionit dhe aplikimi i drejtë në procedurë i dispozitave ligjore me të cilat mbulohet kjo fushë.

Punimet në këtë trajnim fillimisht u fokusuan në trajtimin e kornizës ligjore vendore dhe sfidat praktike në zbatim të saj, identifikimin e vepr-

meve inkriminuese të kryerësit të aksidentit si dhe provat që duhet administruar për vërtetim të shkakut të aksidentit dhe vlerësimi i drejtë i këtyre provave, pasi që në praktikë është vërejtur në shumë raste hapja e procedurës ndaj të pafajshmëve të përfshirë në aksidentet në komunikacion.

Në këtë aspekt u elaboruan edhe faktorët e shkaktimit të aksidenteve me theks të veçantë u trajtuan shpejtësia e palejuar, ndërmarrja e veprimeve jo të drejta të kyçjes dhe ç’ kyçjes në komunikacion si dhe tejkalimi, anashkalimi dhe përballë- kalimi si arsye për shkaktim të aksidentit.

Në fazën e fundit të këtij trajnimi gjyqtarët pjesëmarrës u ndanë në grupe punuese dhe u angazhuan në përfundimin e detyrave praktike që i’ u parashtruan nga trajnuesit.

Gjyqtarët pjesëmarrës në këtë trajnim u angazhuan në çdo fazë të tij me diskutime dhe duke parashtruar pyetje dhe ngritur probleme me të cilat ata hasin në praktikën gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e divizionit të kundërvajtjes.



## E drejta e Azilit- Legjislacioni Vendor dhe Ndërkombëtar

Më 14 maj 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me UNHCR realizoi trajnimin me temë: “ E drejta e Azilit- Legjislacioni Vendor dhe Ndërkombëtar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive dhe bashkëpunimit mes institucioneve relevante që janë të ndërlidhura në një formë me azilin, njohja me karakteristikat e ligjit për azilin të Kosovës dhe raporti i tij me konventën ndërkombëtare për azilin.

Fillimisht në këtë trajnim u elaborua e drejta ndërkombëtare e refugjatëve dhe standardet ndërkombëtare me theks të veçantë Konventa e OKB-së për refugjatë e vitit 1951, me ç’ rast pjesëmarrësit u njoftuan lidhur me detyrimet dhe të drejtat themelore të refugjatëve dhe roli i UNHCR-së në mbrojtjen e refugjatëve.

Faza tjetër e këtij trajnimi u fokusua kryesisht në legjislacionin vendor, në veçanti u trajtua Ligji për Azilin i Kosovës si dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë. Në këtë aspekt u shtjelluan të drejtat e azilantit sipas legjislacionit vendor, procedura e trajtimit të kërkesës për azilin dhe kushtet për pezullimin e kësaj procedure si dhe pushimi i të drejtës për azil.

Punimet në fazën e fundit të këtij trajnimi u

fokusuan në inicimin e konfliktit administrativ për të drejtën e azilit, procedura dhe roli i palëve në konflikt administrativ për të drejtën e refugjatit si dhe procedura ankimore në shkallë të parë dhe shkallë të dytë. Në këtë rrafshë u trajtuan



edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike lidhur me vendimin e shkallës së dytë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar të nivelit themelor dhe të apelit, zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme- departamenti për shtetësi, azil dhe migrim, zyrtarë nga Ministria për Kthim dhe Komunitete si dhe përfaqësues nga OJQ të ndryshme.



## Shpëlarja e parave dhe financimi i terrorizmit

Më 19 maj 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të PTV-së realizoi trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë: “Shpëlarja e parave dhe financimi i terrorizmit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte para së gjithash avancimi i njohurive teorike dhe praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëmarrës për çështjet që ndërlidhen me klasifikimin e veprave penale të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, identifikimi i rasteve kur kemi të bëjmë me këto vepra dhe njohja me institucionet financiare dhe obligimet e tyre në luftën kundër kësaj dukurie.

Fillimisht në këtë trajnim u elaborua legjislacioni vendor që mbulon këtë rrafsh me theks të veçantë dispozitat e Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, format e kryerjes dhe mënyrat që duhen përdorur nga hetuesit dhe prokurori për hetim, zbulim dhe ndjekje penale për pastrim të parave.

Në pjesën e pasdites u trajtuan veprat penale të financimit të terrorizmit, elementet, fazat e kryerjes së kësaj vepre, si dhe vlerësimi dhe

mbikëqyrja e financimit të terrorizmit si një sfidë e madhe në luftën për parandalim të kësaj dukurie.

Gjatë këtij trajnimi prezantoi dhe një zyrtarë i lartë nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) i cili i njoftoi gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës për rolin dhe sfidat që hasin me ç’ rast potencoi rëndësinë e bashkëpunimit me këtë institucion dhe institucionet tjera relevante për



parandalimin e këtyre veprave penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor si dhe prokurorët spe-



## E drejta për gjykim në afat të arsyeshëm, faktorët e brendshëm që ndikojnë në shtyrjen e gjykimeve

Më 25 maj 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Gjykatën Themelore në Prizren, të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, ka realizuar trajnimin me temë: “E drejta për gjykim në afat të arsyeshëm, faktorët e brendshëm që ndikojnë në shtyrjen e gjykimeve”



Qëllimi i trajnimit ishte identifikimi i faktorëve që ndikojnë në zgjatjen e procedurave dhe krijimi i praktikave më të mira në drejtim të gjyqimit

në afat të arsyeshëm.

Me rastin e këtij trajnimi u diskutua dhe u trajtua në përgjithësi për faktorët e brendshëm që ndikojnë në zgjatjen e procedurave, veçanërisht mungesa e palëve të ftuara me rregull.

Gjithashtu u vunë në pah roli i parapërgatitjeve në parandalimin e shtyrjeve si të seancave penale ashtu edhe të atyre civile të cilat ndikojnë drejtpërdrejte në menaxhimin më efikas të lëndëve, menaxhimin më efikas të kohës dhe në këtë kontest edhe në gjykimin në një afat më të arsyeshëm.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, të gjykatave dhe prokurorive nga regjioni i Prizrenit.



## Ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe bashkëpronësia

Më 26 maj 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të PTV-së realizoi trajnim për gjyqtarë me temë: “ Ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe bashkëpronësia”.

Ky trajnim synonte që duke shqyrtuar praktikën relevante gjyqësore lidhur me këto dy forma të pronësisë, të kontribuohet në drejtim të avancimit të njohurive dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve pjesëmarrës me qëllim të unifikimit të standardeve juridike.

Trajnimi kryesisht u fokusua në elaborimin e dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë fushë, kuptimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe të bashkëpronësisë si dhe identifikimin e elementeve specifike dalluese të këtyre instituteve.

Gjithashtu u zbërthyen bazat, natyra juridike dhe mënyrat e krijimit dhe të shuarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe bashkëpronësisë.

Veçanërisht u trajtua procedura e ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe kriteret ligjore që duhet vlerësuar me rastin e

ndarjes si dhe procedura e ndarjes së bashkëpronësisë.

Trajnimi u zhvillua me diskutime interaktive në çdo fazë të tij nga gjyqtarët pjesëmarrës të cilët ngritën dilemat dhe paqartësitë rreth inter-



pretimit dhe implementimit në procesin e vendimmarrjes nga gjykatat.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e gjykatave themelore.





## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

### Ceremonia e diplomimit të gjeneratës së pestë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë në Programin e Trajnimit Fillestar

Më 25 maj 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës organizoj ceremoninë solemne të diplomimit të gjeneratës së pestë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.



Kandidatët për gjyqtarë e prokurorë kanë vijuar trajnimet në Programin e Trajnimit Fillestar të ndarë në tri faza trajnuese. Ky program ka filluar të zbatohet që nga viti 2008 dhe përveç kësaj gjenerate që sot diplomuan, në këtë program trajnimi kanë përfunduar trajnimet edhe 141 kandidatë tjerë në katër gjenerata paraprake.

Në këtë ceremoni mbajtën fjalë rasti, Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, z. Hajredin Kuçi, Ministër i Drejtësisë, z. Fejzullah Hasani,

Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Aleksander Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit dhe Kryesues i Këshillit Prokurorial, z. Enver Peci, Kryesues i Këshillit Gjyqësor, z. Ymer Hoxha, Kryetar i Këshillit Drejtues të IGJK-së, z. Samuel Zhbogar, Udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë.

Nga folësit u vlerësua shumë lartë suksesi i këtij programi duke theksuar si një kthesë pozitive në ngritjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinjë. Në fund të kësaj ceremonie, kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë u shpërndanë diplomat duke u uruar sukses në realizimin e misionit të shenjtë të drejtësisë



## Aktivitetet Tjera

### Formalizimi i bashkëpunimit në mes të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës

Nga data 4-8 maj 2015, një delegacion i IGJK-së në përbërje të Drejtorit të IGJK, Koordinatorit të Programit dhe Udhëheqësve të Programeve trajnuese, me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Kosovë dhe Programit të BE-së TAIEX, kanë qëndruar në Shkollën Kombëtare të Magjistra-



turës së Francës.

Qëllimi i këtij programi studimor është para së gjithash themelimi i bashkëpunimit formal në mes Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës i cili bashkëpunim u formalizua përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të dy institucioneve nga fusha e trajnimeve gjyqësore.

Kjo marrëveshje nënshkruhet me qëllim të forcimit të rolit të trajnimit në përmirësimin e funksionimit të institucioneve gjyqësore dhe promovimin e pavarësisë së gjyqësorit, si dhe përcaktimi i aktiviteteve në kuadër të bashkëpunimit bilateral dhe modalitetet e zbatimit të tyre.

Sipas kësaj marrëveshje Shkolla Kombëtare e Magjistraturës e Francës dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës deklarojnë gatishmërinë e tyre për të vazhduar bashkëpunimin, në varësi të burimeve dhe mundësive në dispozicion të veprimeve që do të kenë të bëjnë me; trajnimin fillestar, trajnimin e vazhdueshëm dhe çdo fushë tjetër në

lidhje me trajnimin dhe informimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve francezë dhe kosovarë. Ky bashkëpunim do të realizohet përmes, shkëmbimit të dokumenteve (publikime shkencore dhe materiale pedagogjike), vizitave studimore, trajnimeve dhe programeve praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë dhe atyre të ardhshëm, misioneve të ekspertizave teknike si dhe pjesëmarrjes së ndërsjellë të gjyqtarëve francezë dhe kosovarë dhe gjyqtarëve të ardhshëm në seminare me tema të interesit të përbashkët.

Gjate kësaj vizite studimore pjesëmarrësit patën rastin të njihen me programet e Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës, lidhur me trajnimin fillestar, provimin pranues dhe atë përfundimtar të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, sistemin e vlerësimit të kandidatëve gjatë trajnimeve, programin e trajnimeve të vazhdueshme, programin e kërkimeve dhe dokumentacionit, programet e bashkëpunimit ndërkombëtarë si dhe aspekte tjera të punës së Shkollës Kombëtare të Magjistraturës të cilat do të kenë ndikim në avancimin e punës profesionale të Institutit Gjyqësor të Kosovës.



## Vizitë studimore në Institutin Nacional të Drejtësisë në Bullgari

Nga data 18-22 maj 2015, IGJK në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE "Mbështetje e Mëtejme në Reformën e Edukimit Ligjor të Kosovës" EULER II, ka realizuar një vizitë studimore në Institutin Nacional të Drejtësisë dhe institucionet tjera të sistemit të drejtësisë në Bullgari për stafin e IGJK-së.

Qëllimi i vizitës së stafit të IGJK-s ishte njohja me sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Bullgarisë, organizimin dhe menaxhimin institucional të Institutit Nacional të Drejtësisë, zbatimin e tra-

jnimit fillestar, trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarë, prokurorë dhe stafin administrativ, veçanërisht funksionimin e Qendrës për Informacion dhe lidhur me mësimin në distancë.

Pjesë e agjendës për stafin ishte edhe vizita në Gjykatën Supreme të Kasacionit, në të cilën u prezantua sistemi gjyqësor i Bullgarisë dhe njëkohësisht u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Institutit Nacional të Drejtësisë së Bullgarisë.



## Raport nga vizita studimore në Bullgari e organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Drejtësisë në Bullgari

Prej datës 18 deri me 29 maj një grup zyrtarësh i përbërë nga gjyqtarë, prokurorë, trajnues gjyqësor, zyrtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe administratorë të gjykatave realizuan një vizitë studimore në kuadër të një programi praktik-shkëmbimi në institucione të ndryshme të gjyqësorit dhe prokurorisë në Bullgari, i cili është organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, ai i Bullgarisë dhe Projekti i BE-së “Mbështetje e reformës së edukimit gjyqësor në Kosovë”. Gjatë kësaj vizite anëtarët e këtij grupi patën rastin të vizitojnë dhe të njihen me punën e institucioneve kryesore gjyqësore dhe prokuroriale të Bullgarisë.

Në javën e parë me interes kanë qenë takimet në Institutin Nacional Gjyqësor të Bullgarisë, Këshillin Gjyqësor Suprem, Gjykatën Supreme të Kasacionit, Prokurorinë e Shtetit, Inspektoratin Gjyqësor, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Supreme Administrative dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Sofjes. Në këto takime grupi ka marrë shpjegime mbi veprimtarinë e këtyre organeve, rezultatet, problemet, metodat e punës dhe sfidat që i kanë ato aktualisht. Gjatë gjithë kohës zyrtarët kosovar kanë shtruar pyetje dhe interesime duke marrë sqarime dhe përvija të çmueshme nga të gjitha këto organe përmes përfaqësuesve të lartë të tyre.

Ndërsa në javën e dytë grupi është ndarë në tre nëngrupe, ku ndaras kanë vizituar Gjykatën e Qarkut në Plovdiv, Gjykatën e Qarkut në Stara Pazova dhe Gjykatën e Qarkut në Veliko Terno-vo. Gjatë takimeve në këto gjykata gjyqtarët, prokurorët dhe zyrtarët e këtyre grupeve kanë marrë njohuri dhe përvija me dobi nga organet, njësitë, gjyqtarët, prokurorët dhe zyrtarët bullgarë në këto gjykata. Në këto takime ka dominuar paraqitja e punës në hollësi e secilit organ, segment të gjykatave dhe njësitëve të tyre duke orientuar trajtimin nga interesimi dhe nevojat apo pyetjet që kanë shtruar zyrtarët kosovar.

Ngjarja kryesore ishte nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me 21.05.2015 në Pallatin e Drejtësisë së Bullgarisë, në mes Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Institutit Nacional i Drejtësisë së Bullgarisë. Ky memorandum u nënshkrua nga Drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës, z.Lavdim Krasniqi dhe ai i Bullgarisë, z. Dragomir Yordanov.

Kjo vizitë do të fuqizojë dhe do të zgjerojë fushat e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve trajnuese në shërbim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqësorit dhe prokurorisë së dy vendeve.





Instituti Gjyqësor i Kosovës

Tel. +381 38 200 18 670  
web: <http://igjk-rks-gov.net>  
e-mail adresa: [infokji@rks-gov.net](mailto:infokji@rks-gov.net)